



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2330/Prot
/2

Tiranë më 27-9 2022

VENDIM

Nr. 41 datë 23.09 2022

PËR
“MIRATIMIN PARAPRAKISHT TË DRAFT MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
MIDIS UNIVERSITETIT TË TIRANËS DHE UNIVERSITETIT ARISTOTEL,
SELANIK GREQI”

Bazuar në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; me nenin 49 pika 1 gërma c,) , Statutit të Universitetit të Tiranës miratuar me Urdhërin e MASR Nr. 816 datë 26.12.2018; V.K.M nr.75, datë 12.2.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;Ligjit nr.115/2021 date 26.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit Nr.1 datë 10.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; Vendimit nr.12, datë 07.04.2022 të Bordit të Administrimit të UT ,”Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 për Universitetin e Tiranës”; materialit të paraqitur nga Rektori i UT-së me shkresën Nr.2330 datë 02.09.2022 “Kërkesë për dhënie pëlqimi mbi draft marrëveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Aristotel të Selanikut, Greqi” ; Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprakisht të draft marrëveshjes së bashkëpunimit midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Aristotel të Selanikut, Greqi”.
2. Efektet financiare që burojnë nga kjo marrëveshje do të miratohen në buxhetin e çdo viti.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

